



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" REKTORI

Njoftim për shpallje konkursi të brendshëm

Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksander Xhuvani", shpallet konkurs i brendshëm, për personel ndihmësakademik me karakter administrativ. Kandidatët e interesuar, punonjës të kategorisë personel ndihmësakademik dhe administrativë, me kohë të plotë të UE-së, që plotësojnë kriteret e përgjithshme e të posaçme etj, në respektim të rregullores në fuqi, miratuar me Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 "Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të Senatit Akademik gjejnë informacionin e mëposhtëm:

Kategoria: personel ndihmësakademik me karakter administrativ.

Pozicioni i punës: Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë,

Përgjegjësi i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, është personel ndihmë akademik me karakter administrativ, që përgjigjet për mbarrëvajtjen e punës në këtë sektor duke koordinuar punën midis specialistëve të sektorit (të marrëdhënieve me jashtë dhe specialistin e projekteve) me drejtorin; u jep zgjidhje teknike dhe ligjore problemeve brenda sektorit duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë; zgjidh mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat për ndjekjen e problemeve duke bashkëvepruar me drejtorin e drejtorisë; raporton tek drejtori, harton raporte, kryen detyrat dhe analiza periodike me përpikmëri e nivel të lartë përgjegjshmërie brenda afateve që i ngarkohen.

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret të përgjithshme e të posaçme:

Kriteret të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhetë ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e argimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi
- të plotësojë kriteret e posaçme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Kritere të posaçme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i Shkencave) ose ekuivalente me të. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite pune;
- Të ketë përvojë pune në IAL;
- Të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vertëtuar me dokumentacion;
- Të ketë kualifikime në fushën e marrëdhënieve me jashtë brenda e jashtë vendit;
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët e interesuar, në respektim të pikës **d** dhe **e** të nenit 6 “Konkursi i brendshëm”; të Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmës akademik në Universitetin e Elbasanit ”Aleksandër Xhuvani” të Senatit Akademik, duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 3 (tri) ditëve pune (15 – 17.12.2025), nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al. dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër interesi
- Dokumentacion shtesë, veç atyre që ndodhen në dosjen personale.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në protokollin e Institucionit.

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht kërkesat dhe dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (12.12.2025 – 31.12.2025). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.